

VENDIM
Nr. 289, datë 2.5.2012

**PËR AKORDIM FONDI FINANCIAR SHITESË KOMUNËS QENDËR BILISHT TË QARKUT TË
KORÇËS, PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT EMERGJENT PËR NDËRTIMIN E URËS SË
POLOSKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 10487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komunës Qendër Bilisht, në qarkun e Korçës, në buxhetin e vitit 2012, t’i jepet fondi financiar shtesë prej 44 934 000 (dyzet e katër milionë e nëntëqind e tridhjetë e katër mijë) lekësh, për zbatimin e projektit emergjent për ndërtimin e urës së Poloskës.

2. Ky fond financiar shtesë të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

3. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Brendshëm, komuna Qendër Bilisht dhe prefekti i qarkut të Korçës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha